




REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. <u>2-D/DPK</u>	Br. Prot. <u>01-1756/13</u>
Dep.	Prot. No.
Nr. Titull	Data
Broj. shifra	Datum
Nr. paqer <u>02</u>	Date <u>04-06-2013</u>
SHIFRE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë **31.05.2013**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-461/13 për z. Xhevat Bekteshi – Drejtor i Auditimit në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike - Vushtrri, për shkak se është parandaluar situata e mundshme e konflikti të interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-461-13, për Zyrtarin e lartë, z. Xhevat Bekteshi – Drejtor i Auditimit në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-461/13, të dyshuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari i lartë, z. Bekteshi së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (Z.D.DPK-01-672/13), pas të cilës zyrtari është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë për të parandaluar situatën e mundshme të konflikti të interesit.

Zyrtari i lartë, z. Bekteshi është deklaruar se do të heq dorë nga të qenurit person i autorizuar i biznesit privat, ose edhe do ta shuaj në tërsi këtë biznes, në mënyrë që të vazhdoi të ushtroj funksionin e tij publik, pa konflikt të mundshëm të interesit.

Ndërkohë, pas këtij takimi, z. Bekteshi në Agjenci ka sjellur informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI-03-1538-13), në të cilën shihet se biznesi D.SH. "Kontabiliteti" në të cilin z. Bekteshi kishte funksion të personit të autorizuar tashmë është shuar në mënyrë vullnetare.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

